



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS**

**MIRATOHET
MINISTRI**

Luan MEMUSHI

**PROGRAMI I LËNDËS
SË GJUHËS ANGLEZE**

KLASA III

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

Tiranë, 2005

PËRMBAJTAJA E PROGRAMIT

- I. HYRJE
- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE OBJEKTIVAT DIDAKTIKË
- III. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE E VETËVLERËSIMIT
- IV. PËRSHKRIMI I KATËR AFTËSIVE GJUHËSORE
- V. PROGRAMET E STUDIMIT
- VI. STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT
- VII. STRUKTURA ANALITIKE E PROGRAMIT
 - TEMAT
 - AKTET DHE FUNKSIONET E KOMUNIKIMIT
 - STRUKTURAT GRAMATIKORE
- VIII. KRITERET PER HARTIMIN E TEKSTIT

I. HYRJE

Në kuadrin e reformimit të sistemit tonë arsimor për përmirësimin dhe përshtatjen e tij më shumë me sistemet përkatëse evropiane, zbatimi i një metodologjie më aktive më pranë interesave të nxënësit, mbështetur në përvojën pozitive të krijuar nga përfshirja e mësimit të gjuhës së huaj në ciklin e ulët, gjuha e huaj angleze do të mësohet si gjuhë e huaj e parë në shkallë vendi, duke filluar në klasën e tretë të CF të arsimit nëntë vjeçar.

Integrimi i vendit tonë në gjirin e familjes evropiane e në strukturat euroatlantike, përgatitja e qytetarit të Evropës së bashkuar, kërkon domosdoshmërisht një njohje dhe zotërim të frytshëm të gjuhëve të huaja, të cilat duhet të fillojnë të mësohen në një moshë sa më të re.

Shkolla fillore është niveli ku hidhen bazat për gjithçka që shoqëria mban si të vlefshme për t'u mësuar, këtu zë vend dhe të mësuarit e gjuhës së huaj angleze.

Sensibilizimi që në moshë të vogël i mësimit të gjuhës angleze është ndihmesë pozitive në formimin e përgjithshëm të nxënësit, të identitetit të tij, zgjeron tek ai mundësinë për të dalluar ndryshimin ndërmjet kulturave.

Përmes mësimit të gjuhës së huaj angleze në shkollën fillore çdo fëmije i jepet mundësi të sensibilizohet me mundësinë për mësimin e gjuhëve të huaja të tjera, si dhe të mësuarit në përgjithësi.

II. SYNIMET EDUKATIVE DHE OBJEKTIVAT DIDAKTIKË

Mësimdhënia/nxënia e gjuhës angleze në moshë të vogël:

- ndihmon në formimin e përgjithshëm të nxënësit;
- shfrytëzon aftësitë moshore, psikike dhe fizike të fëmijës, si: dëshira për të mësuar, nevoja për të komunikuar, gatishmëria dhe aftësia për të imituar, aftësia për të artikuluar, si dhe aftësia për të shprehur veten e tyre në mënyrë krijuese;
- i jep fëmijës një mundësi më shumë për t'u zhvilluar në mënyrë të gjithanshme;
- ndihmon në rritjen e aftësive të tij intelektuale dhe përfshirjen e tij në shkëmbime të shumëllojshme.

Mësimi i gjuhës së huaj në këtë moshë shihet si periudha më intesive në jetën e fëmijëve, si më e përshtatshme për t'i futur ata në një sfidë të re. Fëmijët i përgjigjen të nxënës të gjuhës duke e trajtuar atë si lojë, pra çfarë u jep atyre ose çfarë ata mund të bëjnë me anë të saj.

Të mësuarit e gjuhës angleze në këtë moshë synon:

1. T'i përçojë fëmijës bazat e fillimit të të mësuarit të një gjuhe të huaj që ta përjetojë gjuhën si mjet komunikimi dhe po si të tillë ta përdorë atë.
2. Të ndihmojë në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësit në aspektin njohës, gjuhësor dhe emocional.
3. Ta aftësojë nxënësin për të dëgjuar, për të riprodhuar, për të kuptuar dhe për të krijuar disa elemente të thjeshta të gjuhës së huaj.
4. T'i krijojë mundësi nxënësit të ketë dëshirë të pyesë, të përgjigjet, të përshkruajë objektet e mjedisit rrethues, të kuptojë gjuhën e përdorur nga mësuesi në klasë.

Realizimi i objektivave të mësuar në mbështetjen:

Krijimin e një mjedisi të të mesuarit në mënyrë joformale.

Respektimi i aftësive moshore, psikike, fizike dhe intelektuale të nxënësit është një domosdoshmëri për të siguruar suksesin në punën me këtë grup-moshë.

Nxënësit e kësaj grup-moshe mësojnë më mirë në mjedise joformale. Në bazë të zhvillimit të mësimin të jenë këto këshilla: krijoju ndjenjën se ata po luajnë me gjuhën; lejojini të bisedojnë me njëri-tjetrin; jepuni dhe kërkoni të recitojnë vjersha të shkurtra, të kendojnë këngë, të thonë edhe ndonjë fjalë pa kuptim. Kështu që lodrat, këngët, vjershat, tregimet dhe veprimtaritë fizike ndërmjet tyre do të karakterizojnë të gjithë procesin mësimor. Veprimtaritë të jenë të konceptuara në mënyrë të thjeshtë që nxënësit të kuptojnë se çfarë u kërkohet.

Shumëllojshmërinë dhe vetëshprehjen e nxënësve.

Në çdo orë mësimi, kreativiteti i nxënësve dhe shprehja e tyre të nxiten nëpërmjet veprimtarive dhe detyrave, të cilat vënë në lëvizje dhe zgjerojnë imagjinatën e tyre.

Detyrat e dhëna të jenë brenda aftësive të tyre, pra të jenë të realizueshme, por në të njëjtën kohë edhe nxitëse.

Përdorimi i metodave sa më të larmishme dhe i mjeteve përkatëse didaktike është i domosdoshëm.

Në këtë moshë nxënësit, duke përdorur edhe gjuhën amtare, janë të aftë: të planifikojnë veprimtari të thjeshta, të përdorin arsyetimin e tyre logjik, mund të përdorin një imagjinatë të gjallë, mund të imitojnë duke përdorur intonacione të ndryshme etj.

Rëndësinë e të dëgjuarit.

Të mesuarit nëpërmjet dëgjimit është një komponent thelbësor për mësimin e gjuhës së huaj në moshë të vogël. Mësuesi t'i sigurojë mundësi të plota për zhvillimin e aftësisë të të dëgjuarit nëpërmjet veprimtarive të tilla, si: tregime të bazuara në piktura, fotografi ose në mjete të tjera nxitëse vizuale.

Veprimtaritë me nxënësit e kësaj grup-moshe gjerësisht të mbështeten në të folurit, duke zënë një pjesë të mirë të kohës.

Njohjen me gramatiken.

Nxënësit e kësaj grup-moshe kanë një aftësi të jashtëzakonshme të përvetësojnë gjuhën (gramatikën), duke luajtur me veprimtari që u pëlqejnë. Suksesi i të mesuarit të gjuhës nuk shihet nëse ata kanë mesuar rregullat gramatikore dhe as që duhet synuar kjo deri në moshën 11-vjeçare. Ndërgjegjësimi gramatikor do të arrihet nëpërmjet të dëgjuarit dhe komunikimit apo modeleve që jepen gjatë orës së mësimin sesa nëpërmjet shpjegimeve dhe instruksioneve gramatikore të mirëfillta. Mësuesit të bëjnë kujdes në trajtimin e çështjeve gramatikore dhe të largohen nga tradicinalizmi i trajtimit të tyre. Qortimet gramatikore mësuesi i bën në lidhje me ushtrimet gojore, të cilat praktikojnë forma, si, p.sh.: Do they? Does he/she?, duke theksuar mësimin e modelit dhe jo shpjegim të mirfilltë gramatikor.

Trajtimin e të shkruarit.

Veprimtaritë që lidhen me të shkruarit me nxënësit e kësaj grup-moshe të trajtohen me shumë kujdes dhe në kohën e duhur. Kjo lidhet me nivelin e njohjes së alfabetit dhe tipat e veprimtarive të të shkruarit. Gjithmonë të mbahet parsysh që nxënësit ende nuk kanë përsosur mjaft elemente të të shkruarit në gjuhën amtare.

Trajtimi i gabimeve.

Bërja e gabimeve të shpeshta gjatë mësimin të gjuhës së huaj në moshë të vogël janë normale. Njohja, paraqitja e krahasimi i vazhdueshëm me gjuhën angleze, si dhe praktika e shumë do t' i bëjnë nxënësit të afrohen gjithnjë e më shumë me gjuhën e huaj. Qortimi i shpeshtë vetëm nga ana e mësuesit mund të dëmtojë motivimin dhe zhvillimin e gjuhës.

III. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE E VETËVLERËSIMIT

Mësuesi duke u mbështetur te standardet e dhëna në program, përcakton standarde të pritshme për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga ndryshimet e tyre individuale, gjuhësore, emotive dhe kulturore.

Edhe pse vlerësimi formal mund të mos jetë i detyrueshëm, për këtë grup-moshë është e këshillueshme që mësuesi të mbajë shënime të vazhdueshme për përparimin e nxënësve. Kjo bëhet në mënyrë sistematike dhe ndërthuret gjatë gjithë procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Mësuesi t'u tregojë prindërve ecurinë e fëmijëve të tyre dhe, mbi të gjitha, të flasë me nxënësin për ecurinë e tij dhe ta nxisë për punën që bën. Kjo bëhet shumë thjeshtë, përqendrohet më shumë vëmendja në anët positive në ecurinë e tij dhe jo çka nuk ka mundur të arrijë. Asgjë nuk është më nxitëse sesa suksesi i arritur.

Mësuesi monitoron dhe qorton detyrat duke përcaktuar objektiva të qartë.

Mësuesi sigurohet që nxënësi të përfitojnë dhe të konsolidojnë njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit e të shprehurit për njohuritë e përfshira në këtë program, nëpërmjet formave të ndryshme të vlerësimit.

Format e ndryshme e të larmishme të vlerësimit u krijojnë mundësi nxënësve për të konsoliduar njohuritë e tyre si në klasë, ashtu edhe në shtëpi, duke u dhënë detyra të studiuara specifike me objektiva të qartë që përforcojnë dhe çojnë më tej njohuritë e fituara.

Mësuesi i kushton vëmendje gabimeve dhe ndihmojnë në qortimin e tyre.

Kontrolli gojor, megjithë karakterin e vetë subjektiv, mbetet elementi më i rëndësishëm i vlerësimit të arritjeve në këtë klasë. Kontrolli me shkrim na jep një informacion më të plotë për arritjet, por, siç e theksuam edhe me lart, të shkruarit në këtë klasë nuk zë atë vend që zë kontrolli dhe vlerësimi gojor.

Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv dhe motivues, mund të përdoren tipat e mëposhtëm të ushtrimeve:

Përsëritje, dialogje të shkurtra, plotësime mbi figura, pyetje të tipit “e saktë apo e gabuar”, letra me zëvendësime fjalësh, teste që përfshijnë ngjyrat, ndërtim fjalish të thjeshta, tregime të thjeshtë të përsëritur etj.

Mësuesi, njëherazi, i përdor këto vlerësime për të përmirësuar forma të ndryshme të punës së tij, shikon në mënyrë kritike metodat e tij të mësimdhënies dhe mban qëndrim po në mënyrë kritike për të përmirësuar frytshmërinë e tyre.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës angleze edhe për këtë grup-moshë. Mësuesit të cilët përdorin vetëvlerësimin në procesin e nxënies, ta bëjnë këtë në mënyrë shumë të përshkallëzuar. Nxënësit mësohen të vlerësojnë atë çka është parashikuar të relizohet në program nga ana e tyre. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin të tyre në vazhdimësi.

Rëndësia e vetëvlerësimit nxit të mësuarit e pavarur gjatë gjithë jetës.

Në futjen e vetëvlerësimit gjatë procesit mësimor mund të ndiqen këta hapa:

- Mësuesi diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;
- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte dhe mësuesi bën komentim përfundimtar;
- Puna në grupe nxit nxënësit të vlerësojnë punën e njëri-tjetrit pa nevojën e fodbekut nga mësuesi;
- Nxënësit mbajnë shënime arrijtjet e tyre duke përdorur edhe gjuhën amtare;
- Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arrijtjet e tij.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgegjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit;

Në procesin e mëimit të gjuhëve të huaja vetëvlerësimi mund të përqendrohet në tri aspekte kryesore:

1. Në procesin e mëimit, që do të thotë vlerësimin i përparimit të tyre, nivelin e arritur në secilën shkallë dhe suksesin ose mosesuksesin në realizimin detyrave dhe objektiva të caktuar.
2. Në aftësitë e tyre komunikuese.
3. Në zotërimin e gjuhës, pra në numrin e fjalëve që di, përdorimin e strukturave gjuhësore dhe mënyrën si artikulon gjuhën.

IV. PËRSHKRIMI I KATËR AFTËSIVE GJUHËSORE

Duke u mbështetur te “Vizioni kurrikular-2004” për arsimin nëntëvjeçar, përshkrimet e niveleve synojnë të përcaktojnë arrijtjet e nxënësit për të dhënë formulime të përgjithshme të përvetësimit të gjuhës së huaj. Përshkrimi i një niveli të vetëm është një tregues i përvetësimit të gjuhës nga nxënësi. Mësuesi i përdor përshkrimet e niveleve për të përcaktuar shkallën e përvetësimit nga nxënësit. Mënyra më e dobishme për të përdorur përshkrimet e niveleve, është marrja parasyshe e shkallës së përvetësimit që pritet për çdo grup-moshë.

Shprehitë gjuhësore duhet të ndërthuren e të përdoren gjatë të gjithë procesit mësimor. Ato janë: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit e të shkruarit.

Të dëgjuarit

- Nxënësi reagon përmes veprimtarish fizike ndaj orientimeve, udhëzimeve dhe veprimeve të mësuesit.
- Nxënësi kupton tekste të shkurtra, të shoqëruara me figura, vizatime apo gje të mësuesit.
- Nxënësi dëgjon dhe kupton fjali të thjeshta të artikuluar ngadalë dhe me gjuhë të qartë.
- Nxënësi identifikon objekte të ndryshme të thëna.

Të folurit

- Nxënësi shqipton fjalë ose fraza të thjeshta në mënyrë të përafërt me mbështetje auditive ose vizuale.
- Nxënësi bën pyetje dhe jep përgjigje të shkurtra për atë çka sheh ose dëgjon duke shprehur dëshirat, ndjenjat dhe parapëlqimet e veta.

Të lexuarit

- Nxënësi kupton tekste të shkurtra që përmbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njohur.
- Nxënësi lexon me zë të lartë fjalë dhe fraza të njohura, të mësuara më parë.
- Nxënësi shpreh të kuptuarit e dialogjeve të shkurtra, të ndërtuara me fjalor të thjeshtë.

Të shkruarit

- Nxënësi kopjon fjalë ose fraza të shkurtra, të njohura më parë.
- Nxënësi etiketon objekte rrethore.
- Nxënësi dallon dhe zgjedh fjalë të përshtatshme për të plotësuar vende bosh në fjali apo fjalë të renditura në formë liste.

V. PROGRAMI I STUDIMIT

Të dëgjuarit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Gjuha/struktura
Nxënësi reagon përmes veprimtarish fizike ndaj orientimeve, udhëzimeve dhe veprimeve të mësuesit.	Veprimtaritë e përditshme. Tema: Jeta shkollore dhe gjuha e përdorur në klasë.	Kupton dhe reagon ndaj udhëzimeve bazë, të dhëna në klasë.	Shkolla, klasa. Ndjek dhe reagon ndaj udhëzimeve të mësuesit për kryerjen e detyrës.	Reagon ndaj komandave “Çohu/ulu!”, ”Hap/mbyll!”, “Shiko/dëgjo!”, “Përsërit!” etj.

Të folurit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Gjuha/struktura
Nxënësi shqipton fjalë ose fraza të thjeshta në mënyrë të përafërt me mbështetje auditive ose vizuale.	Jeta vetjake dhe shoqërore. Tema: Marrëdhëniet familjare, prindërit, vëllezërit e motrat.	Reagon ndaj nxitjeve me përsëritje dhe mjete ndihmëse.	Jeta familjare. Identifikon dhe emërton anëtarët e familjes etj.	“Ky është/quhet...”. “Kjo është/quhet...”, për anëtarët e familjes, të afërmit, shtëpia etj.

Të lexuarit

Përshkrimi i nivelit	Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Gjuha/struktura
Nxënësi kupton tekste të shkurtra që përmbajnë fjalë dhe fraza të me fjalor të njohur	Jeta vetjake dhe shoqërore. Tema: Marrëdhëniet familjare.	Kërkon dhe jep informacion për veten dhe familjen.	Marrëdhëniet familjare. Lexon/lidh emrat me tekstin etj.	Tabela e alfabetit, etiketa. Lidh etiketa me figurat. P.sh.: “Ky është...” etj.

Të shkruarit

Tema	Akti i komunikimit	Tema e funksioni	Gjuha/struktura
Marrëdhëniet vetjake dhe shoqërore. Tema: Jeta në familje.	Shkruan emrin, rrugën, qytetin e tij në formë të gërmëzuar. Plotëson në fjalë shkronjat që mungojnë.	Jeta në familje. Kopjon fjalë e fraza të shkurtra, si mjet për të mësuar.	Alfabeti, drejtshkrimi i fjalëve të veçanta dhe frazave të shkurtra.

VII. STRUKTURA VJETORE SINTETIKE

Mësimdhënia e gjuhës angleze në klasën e tretë të CF të arsimit 9-vjeçar do të zhvillohet sipas strukturës vjetore të mëposhtme:

35 javë mësimore X 2 orë/javë	70 orë
Kursi gojor	8 orë
Mësime të reja	50 orë
-Përsëritje	8 orë
-Detyra kontrolli	4 orë

VII STRUKTURA VJETORE ANALITIKE

VII/a Topics/ Temat

1. Every day life

Parts of the body
Home, rooms, furniture
Clothes
Toys
Objects around me
Colours
Meals: food, fruit, vegetables.

2. School life

The classroom
My friends (classmates)
Objects around me
Mathematics: numbers 1-20.

3. The world around us.

Nature
Animals, pets
Zoo

VII/b. Communicative acts\ functions

Aktet dhe funksionet e komunikimit

Greeting friends and teacher.

- Good morning\ afternoon! Hello! Good bye! Bye- bye.

Introducing friends.

- This is Mira. Agim, this is Artan.

Asking about people and answering.

- What is your name ? My name is.....

- Who are you? I am
- How are you? I am fine. Fine thanks.
- Who is this? he/she is
- What is the name of your friend?
- How old are you?
- Have you got a brother, sister ? Yes I have. No I have not.

Asking about things and replying .

- What is this?
- Where is the ball?
- What colour is the shirt?

Being polite when handing things and thanking.

- Here you are. Thank you. Not at all.

Asking and offering.

- A ball please. Can I have a?
- Expressing good Wishes.
- A happy New Year, Merry Christmas, Happy birthday to you!

Asking about location; giving location

- Where are you from?
- Where is your school?

VII/c. Language structures

Elemente dhe struktura gramatikore

Imperatives: Stand up! Sit down! Repeat after me!

Verbs : to be, to have, can (affirmative, interrogative, negative.)

Tenses : Present tense

Articles: A, An, the

Plural of nouns

e.g. : one dog - three dogs

Adjectives.

Big, small, red, green, etc

A red apple. a long pencil, etc

Personal pronouns : I, you, he, she, it.

Possessive adjectives : My, your, his, her.

Prepositions: in, on, under.

There is, there are

This, That

This is a book

That is a door

How many?

Who, what, where.

Ëho is he/she?

What is that?

Where is the book?

VIII. KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT

Teksti “Gjuha angleze-3” për shkollat nëntëvjeçare të jetë rrjedhojë e këtij programi, pra i programit të lëndës “Gjuha angleze për klasën e tretë” të CF. Ndryshe nga vitet e kaluara, teksti “Gjuha angleze-3” të jetë një tekst i përbërë nga dy pjesë: nga libri i nxënësit dhe fletorja e punës, si dhe kasete për veprimtarinë e të dëgjuarit. Për hartimin e tekstit “Gjuha angleze-3” kërkohet të realizohen dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mëposhtme:

Teksti “Gjuha angleze-3” të respektojë programin e hartuar për këtë klasë.

Përzgjedhja dhe vendosja e materialit bëhet në përputhje me një publik specifik dhe mjedis specifik, pra për nxënës të grup-moshës 8-9 vjeç. Prandaj, metoda t’u përgjigjet kërkesave dhe interesave të kësaj grup-moshe. Njëpërmjet tij nxënësi zbulon, vepron dhe bashkëvepron. Autorët janë të lirë të vendosin temat në përshtatje me qëllimet mësimore, gjuhësore strukturore, kulturore dhe ndërthyrjen e tyre. Për të realizuar integrimin, është e nevojshme që teksti të jetë i ndarë me njësi didaktike dhe me linja të caktuara që realizojnë objektiva dhe qëllime të larmishme mësimore. Materiali të jetë tërheqës, me karaktere (personazhe) të pëlqyeshme nga nxënësit e kësaj moshe, me ngjyra dhe figura të shumëllojshme, të cilat të mundësojnë nxitjen e dëshirën e nxënësve në nxënien e gjuhës angleze. Veprimtaritë të jenë të tilla që të nxisin imagjinatën dhe kreativitetin gjatë mësimin. Njëpërmjet mjeteve të mësipërme autorët të mbajnë përasysh futjen e elementeve të kulturës dhe të civilizimit të gjuhës angleze, me anën e të cilave t’u mundësojnë nxënësve njohjen me këtë kulturë.

Këshillohet që aparati pedagogjik i çdo mësimi të shoqërohet me rubrikat përkatëse, të cilat pasyrojnë integrimin e aftësive gjuhësore, duke shmangur nga teksti modelin e aparateve pedagogjike që kanë pamjen e një grupi pyetjesh të renditura njëra pas tjetrës dhe të ndara prej njëra-tjetrës. Planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla, si: të lexuarit, të folurit, të shkruarit e të dëgjuarit, të jenë pjesë përbërëse e këtij teksti të integruara në vetvete dhe në çdo orë mësimi si në pjesën teorike të temave të veçanta, ashtu edhe në pjesën praktike. Veprimtaritë në tekst të ndërtohen duke patur parasysh përdorimin e figurave, të këngëve të shoqëruara me veprime, ngjyrosjen, lojën me letra ngjytëse, dialogje të thjeshtë etj. Teksti të përmbajë: ushtrime me shkrim njëpërmjet historive, përrallave të shkurtra; komente të thjeshta për figura, me etiketa; veprimtari që forcojnë bashkëpunimin; tabela vetëvlerësuese që e lejojnë fëmijën të vetëqortohet.

Rimarrja dhe riciklimi i njohurive, si një parim didaktik, të jetë pjesë e mësimëve që do të përbëjnë këtë tekst, me qëllim lidhjen dhe përforcimin e njohurive të dhëna në mësimet e mëparshme. Këshillohet një mësim përsëritës pas çdo cikël deri në 4 mësimet të reja. Kërkohet që teksti “Gjuha angleze-3” të jetë një tekst, i cili zhvendos veprimtarinë e mësuesit gjatë mësimdhënies, nga një mësimdhënie me mësuesin në qendër, në një mësimdhënie me nxënësin në qendër. Të ketë baraspeshë ndërmjet veprimtarive vetjake dhe kolektive. T’i përshtatet zhvillimit emocional të nxënësve.

Një ndihmesë të madhe në përvetësimin e gjuhës së huaj është funksionimi i të mësuarit të fjalëve të reja me të gjitha elementet bazë të fjalës apo të shprehjeve, duke realizuar trajtimin fonetik mbas çdo mësimi dhe kuptimet gramatikore, leksikore mbas çdo kapitulli. Punët me shkrim nuk janë të detyrueshme si përbërëse e çdo ore mësimore, por të para si mjete që i përfshijnë nxënësit në veprimtari të gjera krijuese dhe zbatuese.

Numri i faqeve 120 A4, me katër ngjyra. Formati 260 x 200 mm.